

KONSULTA GJUHËSORE E PRISHTINËS, 1968

Vështrime për statusin minoritar

Gjuhëtari më i njohur shqiptar atëherë, Selman Riza, krijuesi i teorisë për pangegnishten letrare si gjuhë standarde, po punonte në institutin e sapothemeluar albanologjik, ku do të merrej edhe me kodifikimin, me përhapjen e gramatikave dhe të mjeteve të tjera të standardizimit të gjuhës. Në atë kohë ai shkroi një gramatikë të serbokroatishtes, më të mirën që ka shkruar ndonjëherë ndonjë shqiptar, e cila në konceptin e saj kontrastiv ishte madje e parakohshme.

Paralelisht me mundësitë e vogla të përdorimit të shqipes në Jugosllavi deri në fillim të viteve '60-të sundonte një kaos ortografik. Intelektualët e kishin vënë re këtë dhe e kishin kritikuar rreptë, dhe kishin kërkuar që një gjendjeje të tillë t'i jepej fund. Midis viteve 1961 dhe 1963, në Prishtinë punonte Komisioni i Drejtshkrimit, i drejtuar nga I. Ajeti, i cili më 1964 botoi "Ortografinë". Kjo ishte ortografia më e plotë dhe më e mirë që ishte bërë ndonjëherë për gegërishten. Në të mund të vërehet një afrim sistematik me "Ortografinë" e Tiranës të vitit 1956. Duhet të theksohet se në të hetohej një reduktim maksimal i shënimit të hundoreve dhe të theksave, të cilët duhej ta shënonin kuantitetin e zanoreve. Në vitin 1968, zhvilloi punimet Konsulta Gjuhësore e Prishtinës. Në diskutimet e zhvilluara në të shtroheshin dy aspekte të çështjes: njëra kishte të bënte me zgjedhjen e kodit, përkatësisht me mundësinë që dallimet midis dy varianteve gjuhësore të rrafshoheshin, ndërsa aspekti i dytë prekte drejtpërsëdrejti çështjen që shqiptarët duhej të kishin vetëm një gjuhë të shkruar. Mendohej se ekzistenca e dy varianteve të gjuhës letrare mund të kishte implikime shumë më të gjerë nacionalo-politike.

Vendimi kryesor i Konsultës ishte pranimi i menjëhershëm i projektit të përmendur nga Tirana për një gjuhë të vetme letrare si gjuhë e shkrimit

për shqiptarët e Jugosllavisë.. Rezoluta e dalë nga Konsulta u mbështet publikisht nga kryetari i Kuvendit të Krahinës, Fadil Hoxha. Konsulta gjuhësore e Prishtinës në të vërtetë i dha fund zhvillimit paralel të shkrimit të gjuhës në dy mënyra. Kongresi i Drejtshkrimit katër vjet më vonë në Tiranë, e vërtetoi këtë. Sipas mendimit të R. Ismajlit, këto ishin momentet vendimtare në rrjedhat e standardizimit të shqipes në këto dy dekada. Gjatë gjithë kësaj kohe në Shqipëri bëhej një debat i ashpër politik midis grupeve të ndryshme, tendencave kulturore dhe të tjera, brendapërbrenda ideologjikisht të lejueshme, lidhur me zhvillimet brenda gjuhës. Për shembull, u stilizua si një çështje ideologjike çështja e infinitivit dhe e përdorimit të tij si simbol për gegërishten dhe për traditën e saj të gjatë letrare, kulturore dhe religjioze.. Në Shqipëri po bëhej një debat brenda gjuhës, në gjuhë.

Në Kosovë, ndërkaq, debati po bëhej në një tjetër fushë: statusi i pakicës për shqiptarët si faktor limitues, nga njëra anë, dhe drejt veçimit dhe izolimit të shqiptarëve të Jugosllavisë nga shqiptarët e tjerë, nga ana tjetër, qoftë edhe përmes murit ideologjik, e shtyri elitën kulturore dhe politike shqiptare drejt një debati për gjuhën. Ata kërkonin një status më të mirë për gjuhën shqipe, në pajtim me realitetet e rishtkrijuara në Jugosllavi. Gjuhëtarët kosovarë u morën në radhë të parë me statusin e shqipes në raport me gjuhët e tjera në Jugosllavi dhe jo në radhë të parë me çështje të statusit brendapërbrenda shqipes. Prandaj ata shpesh qenë të detyruar që zgjidhjet e propozuara nga kolegët në Shqipëri për çështje të zgjedhjes së kodit t'i pranonin si të vetat.

Vendimet e Konsultës Gjuhësore të Prishtinës shënuan një kthesë vetëm pas katër vjetësh të një procesi të mëparmë. Sipas mendimit të R. Ismajlit, në rrjedhat e këtij procesi, një rol me rëndësi ka luajtur "Ortografia" e vitit 1964, në të cilën shumë nga tendencat drejt reduktimit të zanoreve ishin pranuar. Fjala ishte për një afrim të rëndësishëm midis dy varianteve në fonetikë, por edhe në morfologji. Konsulta gjuhësore e Prishtinës në Shqipëri u trajtua me kujdes. Rezoluta u botua vetëm me shkurtime dhe me shumë vonesë. U deshën katër vjet për t'i kuptuar porosinë e vërteta të këtyre vendimeve dhe për të organizuar Kongresin e Drejtshkrimit në një rrafsh gjithëshqiptar. Mungesa e informacionit për gjendjen në Kosovë, lajmet për shpërnguljet e atjeshme të shqiptarëve në masë për në Turqi, bashkë me vetizolimën e shtetit shqiptar, të gjitha këto mbase do të kenë ndikuar të krijohej bindja se në Kosovë bota shqiptare ishte tëholluar shumë. Shteti shqiptar, si çdo shtet, kishte krijuar logjikën e mbrojtjes së domeneve të veta dhe të identitetit

shqiptar, kështu që insistimi i kosovarëve për një identitet të përbashkët shqiptar në ato rrethana ideologjike e politike mund të mos kuptohej drejt. Si subjekte jashtë kontrollit, kosovarët mund të dukeshin elementë turbullues: në Rezolutën e Konsultës gjuhësore flitej për nevojën e zhvillimeve demokratike dhe për demokratizimin e mëtejshëm në fushën e kulturës, çka nga ana tjetër në Tiranë mund të shikohej ndryshe, nëse kemi parasysh çështjet e disputave midis dy shteteve. Slogani i Konsultës ishte: “Një popull – një gjuhë letrare”. Historiani kosovar Ali Hadri e ndjente të nevojshme që diskutimin e tij me këtë moto ta përsëriste në Tiranë katër vjet më vonë. Që të kuptohej drejt mesazhi i Konsultës dhe synimi i saj drejt integriteteve gjithëshqiptare, në Shqipëri kishte nevojë për kohë. Në diasporë, ku problemet kosovare mund të mos njiheshin mirë, ku reagimi kundër “shtypjes ideologjike” të traditës kulturore nga shteti shqiptar ishte shumë i lartë, vendimet e Konsultës së Prishtinës u kritikuan. Këto mund të jenë elemente plotësuese për shpjegimin e rrjedhave të kësaj çështjeje (Ismajli, 2003: 91-95).

Identitetet e gjuhës

Brenda gjuhës bëhej një nga debatet më të rëndësishme sa i përket identitetit. Shqiptarët e Jugosllavisë ndiqnin nga afër zhvillimet në proceset e standardizimit të shqipes në Shqipëri dhe u përshtateshin rrethanave. Në vitin 1952, në Tiranë u mbajtën dy konferenca për gjuhën, të cilat karakterizoheshin nga diskutime të gjera për gjuhën letrare, tashmë e kristalizuar me dy variante. Njëra mbështetej në dialektin e Jugut, tjetra në atë të Veriut. Natyrisht, gegërishtja ishte dialekti i shumicës së shqiptarëve të Jugosllavisë. Edhe pse në diskutimet e vitit 1952 mbisundonte qëndrimi zyrtar, sipas të cilit ishte varianti i Jugut ai që do të bëhej gjuhë kombëtare, për shkak të kritikave të rrepta, ato konferenca nuk nxorën përfundime të prera. Në të njëjtin vit, në Prishtinë, u mbajt një mbledhje për gjuhën, në vendimet e së cilës thuhej se gjuha letrare e shqiptarëve të Jugosllavisë duhej të mbështetej në dialektin e Veriut, porse duhej të evitoheshin tendencat diferencuese. Sidomos në fushën e leksikut, rezoluta e kësaj mbledhjeje këmbëngulte në trajtimin e barabartë të fjalëve, pavarësisht nga dialekti. Ajo refuzonte në mënyrë eksplicite mundësinë e krijimit të një kosovarishteje të veçantë letrare.

“Ortografia” e vitit 1956 në Tiranë marginalizonte faktikisht variantin gegë. Në Jugosllavi këto ishin vite shumë të vështira për shqiptarët. Paralelisht po rriteshin kërkesat për të theksuar dallimet midis varianteve

të përdorura në të dy anët e kufirit, sidomos preteksti për përshtatjen maksimale me formën e folur geqe, posaçërisht të Kosovës. E gjitha kjo kishte mundësi të shoqërohej me diferencimin e emërtimit të gjuhës dhe me elemente të tjera. Jo në radhë të parë për këtë arsye, vendimet e vitit 1957 qenë kritikuar publikisht. Pastaj, në vitin 1964, u hartua dhe botua “Ortografia” e Prishtinës për gegërishten, shumë e afërt në parime me atë të Tiranës të vitit 1956.

Në një moment liberalizimi në Jugosllavi, në vitin 1968, në Konsultën Gjuhësore të Prishtinës, intelektualët shqiptarë vendosën të përdornin si gjuhë të vetme për të gjithë shqiptarët atë që në Tiranë ishte propozuar vetëm për diskutim. Ky vullnet identitar i shprehur në një mënyrë kaq të prerë në sloganin “Një komb – një gjuhë letrare” ishte aq mbisundues, sa që eklipsonte edhe vetë diskutimin e çështjeve reale gjuhësore që shtrinin propozimin konkret. Dhe prej andej buronte edhe energjia për të kapërcyer të gjitha vështirësitë praktike, shpesh serioze, për shkak të kufirit të pakalueshëm me Shqipërinë. Pikërisht në emër të identitetit, të cilin e ndjenin të kontestuar në forma të ndryshme nga regjimet, shqiptarët e Jugosllavisë bënë një debat të ashpër për gjuhën, të përqendruar sidomos në çështje që lidheshin me statusin. Nga ana tjetër ishte shteti i Shqipërisë, që përfshinte vetëm gjysmën e kombit, me ritme të tjera të zhvillimit, por pa probleme identiteti. Krijohet përshtypja se ishte i detyruar të përqendrohej kryesisht në domenet e veta, çka reflektohej, natyrisht, në ideologjinë e zgjidhjeve të çështjeve të tilla. Ndërsa në fushën gjuhësore atje bëhej një debat politik e shoqëror brenda gjuhës (Ismajli, 2003: 117-119).

Mospajtimet e Idriz Ajetit

“Ka te ne një kategori e vogël intelektualësh një grimë nostalgjie për faktin që në rrethanat e reja në njëfarë mënyre kanë qenë të shtrenguar të heqin dorë nga përdorimi letrar gegë. Edhe ne dhe shumëkush e ndiejmë një mallëngjim, por vetëm kaq! Do ta ketë ndier edhe vetë shkrimtari i madh kroat Miroslav Kërlezha, për çka poezitë më të fuqishme e më të bukura i shkroi në kajkavishte. Por, ndonjë hap në drejtim të tërheqjes nga rruga e gjuhës letrare kroate as që i shkoi ndonjëherë mendja”,

shkruan Idriz Ajeti.

I lindur në vitin e Komisionit Letrar Shqipëtar të Shkodrës (1917), një ngjarje që për rëndësinë e formimit të gjuhës së përbashkët letrare radhitet me Kongresin e Manastirit, profesor Idriz Ajeti, vjen me një bagazh veprash me peshë të madhe shkencore në fushën e albanologjisë dhe të ballkanologjisë. Emri i tij është bërë sot klasik në degëzimet e shumta studimore albanistike, si njëri nga studiuesit më të rëndësishëm të tyre, e sidomos në formimin e gjuhës së njësuar letrare shqipe, ku ka dhënë kontribute të pallogaritshme. Në artikullin “A ka gja ma punë n’ortografin e gjuhës shqipe?”, I. Ajeti bënte vërejtje lidhur me rregullat e parapara të drejtshkrimit të propozuar, sidomos lidhur me përdorimin e zanores ë (Ajeti: 1958, 471). Ajeti nuk ia mohonte demokratizmin rrugës që është ndjekur këtu, por theksonte faktin se vendimet ishin marrë pa u bërë paraprakisht studime gjuhësore dhe drejtshkrimore.

“E në rast se nuk kemi ndie nevojën e shqyrtimit të këtyne problemeve, atëherë duhej të hajshim arsye e të pranjojmë shkoqitjet e dhanuna prej tjetërkuj mbi këto çashtje”

(Ajeti, 1958: 473).

Vërejtja lidhur me mbledhjen e vitit 1957 të Prishtinës shpjegohej si vijon:

“Kam përshtypjen se vendimet e marruna, ma mirë rekomandimet e dhanuna në mbledhjen e mbrame në Prishtinë u nxorën mbasi u miratuen prej një vargu të tanë pjesëmarrësash, shumica e të cilëve atypëraty morën qëndrim mbi çështjet që po bisedoheshin, pa qenë të vaditun në probleme, orientimit të të cilave i dilshin zot shpeshherë me gjithë shpirt e energji”

(Ajeti 1958: 273).

Pasi ka konstatuar se drejtshkrimi i shqipes mbështetet plotësisht në fonetikën e saj, se disa të folme gege “fonetikiisht qëndrojnë sot bukur larg nga ortografimi zyrtar i shqipes”, ai pohonte se

“as kosovarishtja nuk mund të mirret për themel të gjuhës letrare zyrtare te na”

(Ismajli, 1998: 161).

“Ortografia” e Prishtinës e vitit 1964, në shumë elemente shkante në hap të njëjtë me “Ortografinë” e Tiranës, duke filluar nga mbarështrimi i lëndës, e deri te zgjidhjet e ndryshme konkrete. Fundja, diçka e tillë dhe

kuptohej, po të kemi parasysh se jo më larg se në vitin 1958, vetë kryetari i komisionit për hartimin e kësaj ortografie kishte shkruar:

“Na besojmë se rrugën e përpilimit të ortografisë së gjuhës shqipe te na, mund ta shkurtonte “Ortografija e gjuhës shqipe” e Institutit të Tiranës, pse një numër i madh problemesh drejtshkrimore do të pranohesh prej nesh, atëherë do të mbetet për t’u bisedue vetëm mbi pikat e kontestueshme”.

Këtë ai e thoshte në një kontekst mjaft kritik: “

E në rast se nuk kemi ndie nevojën e shqyrtimit të këtyne problemeve, atëherë duhej ta hajshim arsye e të pranojshim shkoqitjet e dhanuna prej tjetërkuj mbi këto çashtje”

(Ajeti 1958: 473).

Është e qartë se ndërkohë mjaft gjëra kishin ndryshuar, kishin ardhur edhe njerëz të tjerë, vetë anëtarët e Komisionit me siguri tashmë “...e kishin ndie nevojën e shqyrtimit të këtyne problemeve” dhe kishin arritur edhe përfundime të caktuara (Raka, 1997: 201-209).

Dy “Ortografitë”, pas gjithë kësaj pune, paraqesin mjaft ngjashmëri në vijat kryesore të gjetjes së zgjidhjeve. Dhe pikërisht ky element është shumë i rëndësishëm për zhvillimet e mëtejme në fushën e standardizimit të shqipes. Në punën e normëzimit të gegërishtes nuk ndiqej më ndonjë vijë që nuk do ta merrte parasysh ekzistencën edhe të një varianti të shqipes, e as nevojën e gjetjes së zgjidhjeve sa më të afërta. Përkundrazi, duke i ruajtur dallimet themelore, theksoheshin në mënyrë tacite elementet e ngjashme, të afërta apo të njëjta. Në këtë kuptim kjo “Ortografi” i hapte rrugën procesit që do të vinte 4 vjet më vonë në këtë fushë: njësimin të drejtshkrimit të shqipes, çka u shoqërua edhe me një tjetër element, këmbënguljen e opinionit për të bërë njësimin e shqipes letrare në tërësi, pra jo vetëm të drejtshkrimit.

Konsulta gjuhësore 1968

Nga mesi i muajit prill të vitit 1968, “Rilindja” pa shumë zhurmë i njoftonte lexuesit e vet se së shpejti një temë e rëndësishme gjuhësore do të diskutohej në Prishtinë (Rrecaj, 1968). Me 18. 4. 1968, në faqen 10 të saj, nisi të botohej në vazhdimë teksti i I. Ajetit “Rruga e njësimin të shqipes letrare”. Këtij teksti, referat në mbledhjen ku do të diskutohet çështja

e përmendur, i paraprinte një shënim i shkurtër i redaksisë, në të cilin lexuesi njoftohej lidhur me “Projektin e drejtshkrimit të gjuhës shqipe” të hartuar nga Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë i Universitetit të Tiranës në 1967-n, për të cilin po bëhej diskutim publik. Në këtë diskutim po merrte pjesë “Rilindja” me botimin e projektit në faqet e saj dhe me botimin e ndihmesave të tjera për këtë çështje. Me këtë qëllim e në këtë frymë redaksia njoftonte se po e botonte referatin e I. Ajetit. Një ditë para fillimit të Konsultës, duke njoftuar për veprimtarinë e Institutit Albanologjik, me fjalët e F. Aganit, raportohej se, përveç Simpoziumit për Skënderbeun, do të mbahej një konsultë me rëndësi për gjuhën me 22 prill 1968 (cit. Ismajli, 1998: 177/Jasiqi: 1968a, 11). Në këtë mënyrë njoftohej se me një punë të tillë në fakt po merreshin specialistët dhe institucionet përkatëse shkencore dhe kulturore dhe jo institucionet shtetërore si më parë. Është e qartë se institucionet e tilla do të ishin më të ndjeshme ndaj opinionit publik e shkencor (po aty, 177).

Ditën kur i filloi punimet Konsulta për Gjuhën, “Rilindja” botonte referatin e I. Ajetit në faqen 8. Në fund të referatit të profesor Ajetit lexohej:

“Njësimi i drejtshkrimit në stadin e sotëm, paraqet pas mendimit tonë hapin vendimtar për punën e afrimit të varianteve letrare të gjuhës sonë të shkrimit. Në qoftë se duem t’i riejmë dy variantet e gjuhës sonë letrare, të gjuhës sonë të shkrimit, ato sot mund të na dalin të afrueme në një shkallë të madhe, sa të sillen në to dy tipare dalluese: nazalizmi i vokaleve i njenit, dhe rotacizmi i tjetrit”

(Ismajli, 1998:177).

Ai përmendte çështjen e vokalit ë, dallimet e diftongjeve **ue/ua** dhe participin, që “...toskënishtja e ka të plotë, ndërsa gegënishtja të cunguem”, Rexhep Ismaili, po aty theksonte :

“Na menojmë që Kuvendimi ynë këtë çështje duhet ta shtrojë e t’u drejtohet letrarëve, gazetarëve dhe të gjithë atyre që variantën e gjuhës së shkrimit ta shpien në përdorimin me tri a katër pika dalluese nga variantja toske e gjuhës sonë letrare”

(Po aty, 178).

Formulimet kyçe të I. Ajetit në referatin e paraqitur në Konsultë ishin:

“Njësim i drejtshkrimit, afrim i varianteve letrare të gjuhës sonë të shkruar dhe dallim me tri a katër pika dalluese nga variantja toske e gjuhës sonë letrare”.

Për zhvillimin e ideve dhe të debateve në këtë fushë, vlen të theksohet se në rimarrjet e pastajme të këtij referati, fjalia e fundit që u citua këtu nuk figuronte më, ashtu siç nuk figurojnë dhe disa pika të tjera referimesh apo diskutimi (Ajeti, 1972: 105). Nuk mund të mos shihet po ashtu se, më gjithë frikën me të cilën po e shtronte propozimin për afrimin sa më të madh të dy varianteve të gjuhës letrare (të kemi parasysh përvojat e viteve '57-'58), profesor Ajeti synonte njësimin e tyre në të gjitha fushat e tjera, pos në dallimet e prodhuara me kompleksin nazalizëm/rotacizëm. Mirëkuptimi dhe kërkesa që shtronte opinioni në Konsultë ia shtonin atij bindjen për nevojën e njësimin të gjuhës, përtej vështirësive të realizimit të menjëhershëm, për të cilat ai ishte më i vetëdijshëm se të tjerët.

Afrim e njësim

Më 23 prill "Rilindja" e intensifikoi raportimin nga kjo ngjarje jo vetëm kulturore. Ndryshe nga trajtimi i deriatëhershëm, tani ajo godiste që në faqen e parë: "Nji komb – nji gjuhë letrare" me mbititull "Konsultë për njësimin dhe ortografinë e shqipes letrare". Siç shihet, tani formulohej qartë qëndrimi se fjala ishte për njësimin e gjuhës letrare dhe të ortografisë së saj në frymën e sloganit "Nji komb – nji gjuhë letrare". Raportuesi nga mbledhja, në faqen 5 të gazetës citonte fjalën e F. Aganit, drejtor i Institutit, i cili ishte organizator i Konsultës bashkë me Katedrën e Gjuhës Shqipe të Fakultetet Filozofik të Prishtinës (më 1960 në Prishtinë u hap Fakulteti Filozofik, filial i Universitetit të Beogradit... Më 1962 aty u nxor numri i parë i revistës "Gjurmime albanologjike", e cila më vonë do të kalonte në Institutin Albanologjik).

Në fjalën e tij programore për punën e Konsultës, ndër të tjera, Agani thoshte:

"Fenomeni dialektor, fenomeni i ekzistimit të dialekteve, siç dihet, nuk është fenomen vetëm i shqiptarëve, as karakteristike vetëm e tyre. Dialektet janë produkt i pashmangshëm i ndarjes së pazhvilluar të punës dhe shkëmbimit të dobët, i komunikimit të paktë, i copëtimit, partikularizmit e regjionalizmit feudal. Por ne nuk jemi mbledhur këtu për këtë gjë. Jemi mbledhur për të diskutuar për rrugët e afrimit të mëtejshëm apo të unifikimit të gjuhës shqipe letrare, për mundësitë e një ortografie të përbashkët të shqipes. Këtë diskutim për mundësitë e rrugët e unisimit të shqipes letrare dhe për ortografinë e përbashkët e bën të mundshme para

së gjithash shkalla e lartë e afërsisë së të folmeve shqipe të sotme. Pikërisht kjo afërsi, shpresojmë, duhet të jetë një prej konstatimeve dhe një prej insistimeve të para të tubimit tonë. Kjo afërsi relative e të folmeve të shqipes është rezultat i tërë zhvillimit shoqëror shqiptar që nga Rilindja e këndeje, përgjithësisht, e para së gjithash – rezultat i zhvillimit letrar, arsimor e kultural dhe i mirëkuptimit për këtë çështje të flamurtarëve të këtij zhvillimi. Kësaj afërsie i kontribuen në mënyrë të konsideruar edhe konsultimet tona të përparshme gjuhësore”

(Theksime sipas Rexhep Ismajlit, 1998: 179).

Më 24 prill 1968, “Rilindja” po në faqen e parë botonte artikullin “Shqipe letrare e ortografi unike”, me mbititull “U dha fund punimeve Konsulta për njësimin dhe ortografinë e shqipes letrare” (Ismajli 1998: 181), dhe me nëntitull “Në projekt nuk ka divergjenca esenciale të dy dialekteve”. Qysh në tituj dhe në mbitituj këmbëngulej në formulimin “Konsulta për njësimin dhe ortografinë e shqipes letrare”, ndërsa në brendi i mëshohej më shumë shpjegimit se as në projektin e ortografisë së vitit 1967 dhe as në realitet nuk ka dallime shumë të mëdha dhe esenciale midis dialekteve të shqipes dhe varianteve letrare përkatëse, çka në fakt ishte çështja kryesore për specialistët e gjuhës të pranishëm aty apo kudo gjetiu. A. D. Jasiqi ndër të tjera raportonte:

“... Kujdesi ma i madh në këtë tubim iu kushtue çashtjes së njësimin të gjuhës letrare si nevojë të domosdoshme dhe të kohës, për çka u shprehën pa rezervë të gjithë pjesëmarrësit tue vue në dukje se tashma janë pjekë të gjitha kushtet për marrjen e një hapi të këtillë, pa marrë parasysh vështirësitë që mund të dalin në këtë drejtim”

(Po aty, 181).

Në vijim të raportit, në faqen 5 të gazetës njoftohej se I. Ajeti kishte diskutuar në frymën që do të përkrahte vërejtjet konkrete për projektin e ortografisë, sepse vërejtjet nuk e cenonin atë.

Më 25 prill 1968, “Rilindja” merrej me Konsultën Gjuhësore intensivisht dhe gjithnjë në faqen e parë. Paralajmëronte “Konkluzat e Konsultës gjuhësore” të botuara në faqen 11. Po në faqen e parë botonte artikullin “Njësimi i gjuhës letrare dhe ortografisë – Kontribut për zhvillimin e kulturës”, me shënimin “Nga biseda e Fadil Hoxhës, kryetari i Kuvendit të Krahinës Autonome Socialiste të Kosovës, me delegacionin e Konsultës gjuhësore” (Po aty, 182). Siç jam informuar (R. Ismajli) nga bashkëbisedues

që kanë marrë pjesë drejtpërsëdrejti në këto punë, propozimi i tekstit të Konkluzave të Konsultës Gjuhësore të Prishtinës ishte hartuar nga Hilmi Agani dhe Besim Bokshi. Pika 7 e këtyre Konkluzave ishte propozuar dhe hartuar nga Fehmi Agani. Të nëntë pikat e Konkluzave ishin miratuar unanimitisht. Procesmbajtës kishin qenë Murat Blaku, asistent në degën e Gjuhës Shqipe, dhe Ismajl Dumoshi, profesor i gjuhës shqipe në shkollat e mesme të Prishtinës (Ismajli, 1998: 183).

Gjatë muajit prill, “Rilindja” (cit. Ismajli... Jasiqi:1968a, 8) botonte një artikull komentues lidhur me Konsultën Gjuhësore, në të cilin, duke u ndërlidhur me komentet e H. Aganit në diskutimet e Konsultës, duke përsëritur argumentimet e A. Kostallarit, shpjegonte me një ton gati polemizues se nuk është fjala për zgjedhjen e toskërishtes për gjuhë letrare, po për një cilësi të re mbidialektore. Ky koment sikur donte të tregonte se në ç’pikë do të kenë qenë dilemat dhe vërejtjet e atyre që eventualisht mund të kenë pasur rezerva, dilema dhe rezerva, që në fakt kuptoheshin dhe ishin thënë dhe më parë e më vonë në qarqe të ndryshme gjuhëtarësh dhe veprimtarësh të kulturës. Në vijim “Rilindja” do të botonte diskutime lidhur me çështje të drejtshkrimit, nga autorë nga Kosova, po edhe më shpesh do të rimerрте diskutime që botoheshin në shtypin dhe periodikun e Shqipërisë (Ismajli, 1998: 188).

Përfundimet e Konsultës Gjuhësore të Prishtinës, 1968

Përfundimet e Konsultës Gjuhësore të Prishtinës, hartimin e të cilave e kishin bërë Hilmi Agani dhe Besim Bokshi, me një shtesë të Fehmi Aganit (pika 7), e të cilat janë botuar në formën e miratuar, janë:

Tubimi shpreh bindjen se njësimi i shqipes letrare është rezultat i natyrshëm i proceseve progresive të shoqërisë shqiptare, veçanërisht nga Rilindja e këndej.

Mbledhjet e viteve 1952, 1957 dhe 1963, që u mbajtën në Prishtinë e që trajtuan çështjet e gjuhës e të ortografisë shqipe, me gjithë lëkundjet në disa pika, luajtën një rol pozitiv në stabilizimin e shqipes letrare.

Tubimi i 22 e 23 prillit të vitit 1968 bëri një hap drejt mënjanimi të disa divergjencave që në të shkruar kanë ekzistuar në praktikën e deritashme dhe njeh, njëzëri si gjuhë të veten letrare gjuhën letrare të vendit ëmë.

Projekti i ortografisë që u zu ngoje, e që shërbeu si bazë diskutimi në këtë Konsultë, porsa të aprovohet dhe të marrë formën zyrtare në Republikën Popullore të Shqipërisë, do të zbatohet.

Në ndërkohë, d.m.th. derisa të aprovohet, projekti ekzistues është bazë

e shëndoshë dhe mund të zbatohet dhe të konsiderohet si ortografi shqipe.

Vetë projekti, në disa pika, ka nevojë të shqyrtohet më me kujdes dhe vërejtjet e argumentuara dhe shkencërisht të arsyetuara, mund të jenë vetëm të dobishme. Në këtë kuptim Konsulta e shih të udhës një diskutim, në rend të parë me anë të shtypit, ku do të trajtoheshin çështjet e ortografisë për të cilat, pjesëmarrësit në diskutim mendojnë se janë të diskutueshme dhe mund të zgjidhen më drejt shkencërisht. Diskutimi rreth pikave kontestuese nuk pengon zbatimin e drejtshkrimit në fuqi.

Tubimi konstaton se ky hap i rëndësishëm drejt unifikimit të gjuhës letrare, kur është fjala për shqiptarët në Jugosllavi, rezulton nga zhvillimi i tyre i deritashëm arsimor e kultural, mundësohet e favorizohet nga demokratizimi i marrëdhënieve shoqërore dhe trajtimi i drejtë socialist i pozitës e i funksionit të kombësisë, të relacionit kombësi – kombi ëmë e të çështjeve të trashëgimisë e të unitetit të kulturës kombëtare.

Tubimi autorizon Institutin Albanologjik dhe Katedrën e Gjuhës dhe të Letërsisë Shqipe, si organizues të kësaj Konsulte, që ta njoftojnë Universitetin Shtetëror të Tiranës me Konkluzat e tubimit dhe me vërejtjet e bëra rreth projektit të ortografisë.

Instituti e Katedra autorizohen t'u rekomandojnë institucioneve e enteve arsimore e pedagogjike, gazetare e botuese, shkencore e kulturele që të krijojnë mundësitë e zbatimit sa më të shpejtë të Konkluzave të Konsultës (cit. Ismajli: 1998, 316/Versioni i botuar në "Gjurmime albanologjike 1": 1968, 29-56. Konkluzat janë botuar dhe në revistën "Përparimi" nr. 3-4: 1968, 325-326).

Ndër intelektualë, veprimtarë të kulturës, studiues, po edhe politikanë të shquar në Kosovë, në saje të përvojës së deriatëhershme, ishte krijuar bindja se në fushën e gjuhës interes me rëndësi kombëtare kishte afrimi dhe njësimi me pjesën tjetër të kombit, duke i dhënë përparësi me këtë rast në radhë të parë asaj që ndyshe quhet "debat për gjuhën" dhe duke lënë që "debati në gjuhë", brenda gjuhës, të bëhej në kohë të tjera, apo dhe të mos bëhej fare. (cit. Ismajli 1998:189/shih Williams, 1992: 123-147). E vërteta është se edhe në Kosovë do të jenë bërë debate të tilla në gjuhë, pikërisht ashtu siç tregojnë diskutimet e viteve 1955-1958, kur prapa shprehjeve si "thjeshtim", "afrim jo njësim", apo edhe prapa deklarimeve më të hapura mund të qëndronin pikëpamje e motive të tjera, të cilat mund t'i shohim vetëm po të gjenden diskutimet e plota (Ismajli, 1998: 190).

Ali Hadri shprehte bindjen se zgjidhja "Një komb – një gjuhë letrare, një drejtshkrim" do ta kishte përkrahjen e plotë të "bashkësisë socialiste", në një anë, dhe "përqaftimin e përzemërt të kombit ëmë", në anën tjetër. A.

Hadri, një nga ata intelektualë që ndër të parët kishin pasur rastin të hynin në këmbimet me Tiranën pas vitit 1968, në Kongresin e Drejtshkrimit në Tiranë më 1972, besoj jo rastësisht, kumtonte afërsisht të njëjtën gjë: “Një komb – një gjuhë letrare kombëtare” (cit. Ismajli, 1998: 191/Hadri, 1973: 395-398). Me këtë rast ai e shihnte të udhës ta theksonte posaçërisht vazhdimësinë nga Rilindja Kombëtare e këndej, për të vënë në pah edhe një herë se “nuk mund të flitet për dy kultura, kulturë kombësie dhe kulturë kombëtare”, se “ekziston një kulturë kombëtare” (Ismajli, 1998: 191).

Sipas theksimeve të R. Ismajlit,

“Më duket se Tirana ishte e befasuar me vendimet e Konsultës së Prishtinës, madje e papërgatitur për të reaguar në mënyrë përkatëse. U deshën 4 vjet zbatimi me shumë entuziazëm të normës që në fakt ishte vetëm projekt, që të organizohej Kongresi i Drejtshkrimit. Jam përpjekur të shoh si janë pritur atëherë në Tiranë, në opinionin shkencor albanistik, Konsulta Gjuhësore e Prishtinës dhe Konkluzat e saj. Kam shfletuar numra të viteve 1968-1971 të revistave “Studime filologjike” dhe “Studia albanica”, sepse revistat e tjera nuk kam pasur mundësi t’i kem. Kam ndeshur të përmendet kjo Konsultë për herë të parë në studimin e Androkli Kostallarit “Mbi disa veçori strukturore e funksionale të gjuhës letrare shqipe të kohës sonë” të vitit 1970 (Kostallarit: 1970, 362). Duke theksuar shtrirjen e funksioneve të shqipes letrare “në fushën e publicistikës, të arsimit, të kulturës e të shkencës edhe në popullsitë shqiptare që banojnë jashtë kufijve të sotëm të shtetit tonë kombëtar”, Kostallari shënonte: “Siç dihet, në vitin 1968, në Konsultën e përfaqësuesve të të gjithë shqiptarëve që banojnë në Jugosllavi fitoi dhe u miratua kërkesa që gjuha letrare kombëtare shqipe e kohës sonë të përdoret edhe nga shqiptarët e atjeshëm, sipas parimit “një komb – një gjuhë letrare”. Dhe kjo gjuhë ka filluar tashmë të funksionojë atje si gjuhë kulture jo vetëm në fushën e prozës, por edhe të poezisë” (cit. Ismajli: 1998, 201/Kostallari: 1970, 45). Dhe, për të krijuar një ide si duket kjo gjuhë letrare e përdorur nga autorët kosovarë, Kostallari citonte vjersha nga poetët A. Podrimja, A. Shkreli dhe D. Mehmeti të botuara më 1969. Shënimet e para pak më të plota për zhvillimet në fushën e normimit të shqipes letrare te shqiptarët e ish-Jugosllavisë, sa kam parë, në Tiranë jepeshin publikisht në Kongresin e Drejtshkrimit të mbajtur më 20-25 nëntor 1972 në Referatin e Idriz Ajetit (Ajeti 1973:109-118. Botuar në materialet

e Kongresit) dhe në kumtesën e Remzi Nesimit (Nesimi: 1973, 119-122). Në referatin e Androkli Kostallarit në Kongresin e Drejtshkrimit theksohej në mënyrë të veçantë fakti se te shqiptarët e Jugosllavisë “në të gjithë veprimtarinë shoqërore, arsimore, kulturore e shkencore, ndër të tjera edhe në gjinitë e ndryshme të letërsisë artistike, përdoret pothuajse pa përjashtim gjuha letrare kombëtare shqipe e kohës sonë dhe drejtshkrimi i saj në bazë të vendimit të konsultës së gjerë shkencore të Prishtinës që u mblodh në prill të vitit 1968”. Kjo rrugë zhvillimi gjeti shprehjen e saj të kodifikuar edhe në “Ortografinë e gjuhës shqipe”, që u botua në Prishtinë më 1964, shumë të afërt me Ortografinë e vitit 1956, vepër që ndihmoi për të kaluar më vonë në një drejtshkrim të njëzuar”

(cit. Ismajli: 1998, 203/Kostallari: 1973, 64-65).

Gjurmues i shqipes

Akademik Idriz Ajeti i pasionuar për ta gjurmuar fjalën shqipe dhe i paepur kundruall furtunave antistandarde, vazhdon të japë kontribute të reja dhe të jetë një gjurmues i papërsëritshëm i shqipes në thellësinë e mendimit dhe akribinë shkencore. Përkujdesja e vazhdueshme për shqipen standarde, rrahja e problemeve me të cilat përballet praktika jonë gjuhësore në zbatimin e normave në të gjitha sferat e komunikimit publik, dhe gjetja e zgjidhjeve të drejta përkatëse – këto kanë qenë fushat në të cilat Prof. I. Ajeti ka punuar një shekull jete (Murati: 2015, 15). Gjykimet e tij largpamëse, me të cilat u jep udhë problemeve të shumta të koklavitura të gjuhës letrare, Prof. I. Ajeti i ka thellësisht të argumentuara, sa që atyre është vështirë t’u heqësh apo t’u shtosh ndonjë presje edhe nga perspektiva e gjendjes së sotme. Edhe metagjuha e veprës së I. Ajetit është një model sesi duhet të shkruhet shqipja standarde apo shqipja- shqip. Ajo është e shkruar me një fjalor të përzgjedhur, me gramatikë në kuptimin e vërtetë të kësaj fjale dhe me sintaksë model, që të tërheq për ta lexuar deri në fund. Askush nuk e ka shkruar shqipen më mirë se ai.

Tani është koha të planifikohet një kongres për gjuhën shqipe, sepse që nga Kongresi i Drejtshkrimit, në vitin 1972 e deri më sot, nuk është mbajtur asnjë kongres tjetër gjuhësor. Mendoj që Akademia e Shkencave të Shqipërisë dhe Akademia e Shkencave të Kosovës duhet të mendojnë për mbajtjen e një kongresi, në të cilin mund të planifikohen, si çështjet enciklopedike (sepse këto vit janë bërë zhvillime të natyrave të ndryshme)

ashtu edhe çështjet për terminologjinë e teknologjisë (sepse tani më shumë se kurrë teknologjia është zhvilluar aq shumë saqë kanë depërtuar shumë lehtë në gjuhën shqipe terma të teknologjisë). Pra, është koha të mendojmë për pasurimin e terminologjisë gjuhësore shqipe, dhe për pasurimin e leksikut të shqipes.

Bibliografia

1. Ajeti, I. “Rruga e njësimit të shqipes letrare”, “Probleme të gjuhës letrare shqipe dhe të drejtshkrimit të saj”, 1972, Tiranë, f. 105.
2. Ajeti, I. “Rruga e njësimit të shqipes letrare në Kosovë”, “Studime filologjike”, 1978, Tiranë.
3. Ajeti, I. “Çështje të gjuhës letrare shqipe”, “Studime gjuhësore IV”, Rilindja, 1989, Prishtinë.
4. Ismajli, R. “Gjuhë dhe etni”, “Rilindja”, 1991, Prishtinë.
5. Ismajli, R. “Në gjuhë” dhe “për gjuhë”, 1998, Pejë, f. 177-189.
6. Ismajli, R. “Standarde dhe identitetet”, Dukagjini, Pejë, 2003, f. 91-95/ 117-119.
7. Ismajli (1982), Rexhep. “Idriz Ajeti për historinë e gjuhës shqipe”, “Rilindja”, Prishtinë, 21.8
8. Figurë qendrore e studimeve të shqipes; Konferencë shkencore “Profesor Idriz Ajeti në 100-vjetorin e lindjes”, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2017.
9. Studime 14/2007. Me rastin e 90-vjetorit të lindjes së akademik Idriz Ajetit, ASHAK, Prishtinë, f. 273.
10. Shqipja standarde dhe gjendja aktuale e përdorimit të saj; Konferencë shkencore, kolegji “Iliria”, Prishtinë, 2018.
11. “Ortografia e gjuhës shqipe”, 1964, (Komisioni: Dr. I. Ajeti, kryetar; Dr. P. Janura, S. Drini, H. Vokshi, M. Bardhi, I. Mulaku, M. Isaku, Xh. Gega dhe L. Luçaj), Beograd, 66.
12. “Përparimi” nr. 3-4: 1968, f. 325-326.
13. “Fjalori enciklopedik shqiptar” (1985).
14. <http://ashak.org/?cid=1,45,639>

ART, TRADITË DHE KULTURE

Univers

